

LIGJ
Nr.7585, datë 14.7.1992

PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT PERSONALE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Personat fizikë, vendas e të huaj, që realizojnë të ardhura personale në territorin e Republikës së Shqipërisë, detyrohen të paguajnë tatim.

Person fizik i huaj për efekt të pagimit të tatimit konsiderohet personi që ushtron veprimtari ekonomiko-tregtare në vazhdimësi në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë mbi 183 ditë gjatë një viti tatimor.

Neni 2

Tatimi mbi të ardhurat personale vendoset mbi këto kategori të ardhurash:

1. Të ardhurat nga pagat.
2. Të ardhurat nga shpërblimet që realizohen nga shërbimet personale, që kryhen për llogari të të tretëve.
3. Të ardhurat nga e drejta e autorit dhe dividendët.
4. Të ardhurat nga llogaritë dhe konkurset parashikuese.
5. Të ardhurat e tjera që përcaktohen si të tatueshme nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Neni 3

Nga tatimi mbi të ardhurat personale përjashtohen:

1. Dhuratat dhe trashëgimitë
2. Të ardhurat që paguhen nga Instituti i Sigurimeve për rastet e aksidenteve dhe të vdekjeve.
3. Të ardhurat nga Sigurimet Shoqërore për raportet e pa aftësisë së përkohëshme, të leje e barrëlindjeve dhe pensionet.
4. Bursat e nxënësve dhe studentëve.
5. Të ardhurat për mbulimin e shpenzimeve të transferimit dhe për udhëtim e dieta si dhe shpenzimet për investime.
6. Të ardhurat që përfitohen nga përdorimi i fondit të ndihmës sociale.
7. Të ardhurat nga interesat e depozitave të kursimit të shtetasve.
8. Të ardhurat nga asistenca sociale.
9. Të ardhurat e tjera që përcaktohen si të patatueshme nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Neni 4

Nga tatimi mbi të ardhurat personale përjashtohen të ardhura që rrjedhin nga pagat deri në 2500 lekë në muaj.

Neni 5

Të ardhurat nga pagat mbi 2500 lekë në muaj taten si vijon:

1. Kur paga mujore është 2501-3000 lekë, shuma mbi 2500 lekë tatohet 10 %.
2. Kur paga mujore është 3001-3500 lekë, shuma nga 2501 deri në 3000 lekë tatohet 10 %, kurse shuma nga 3001 deri në 3500 lekë 20 %.
3. Kur paga mujore është 3501 lekë e lart, shuma 2500 deri 3000 lekë tatohet 10 %, kurse shuma nga 3001 deri 3500 lekë tatohet 20 % dhe shuma 3500 lekë e lart tatohet 30 %.

Neni 6

Të ardhurat që përfitohen sipas pikave 2, 4 dhe 5 të nenit 2 taten 20 %, ndërsa të ardhurat sipas pikës 3 taten 10 %.

Neni 7

Tatimi mbi të ardhurat personale për punonjësit në marrëdhënie pune me shtetin ose me ndërmarrjet me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj llogaritet nga dega e financës për çdo muaj dhe derdhet në buxhetin e shtetit në të njëjtën kohë me tërheqjen e pagave.

Neni 8

Punëdhënësit privatë detyrohen të regjistrojnë pagat e të punësuarve, të ndalin tatimin dhe ta derdhin atë në buxhetin e shtetit në të njëjtën kohë me dhënien e pagave.

Neni 9

Banka detyrohet të vërtetojë, në momentin e tërheqjes së pagave të punonjësve, ndalesat dhe derdhjet në buxhetin e shtetit të tatimit mbi të ardhurat personale.

Neni 10

Të ardhurat personale që rrjedhin nga burimet e parashikuaranë pikat 2, 3, 4 dhe 5 të nenit 2 të këtij ligji, llogariten mbi bazën e deklaratës personale.

Neni 11

Quhen shkelje të ligjit :

1. Fshehja dhe falsifikimi i të ardhurave personale.
2. Mosevidencimi i të ardhurave personale.
3. Moskryerja e ndalesave dhe e derdhjeve të tatimit mbi të ardhurat personale.
4. Mosdhënia ose dhënia e deklaratës me vonesë.

Neni 12

Për shkeljet e parashikuara në nenin 11 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, merren këto masa:

1. Për rastet e parashikuara në pikën 1 të nenit 11 të këtijligji, personat fajtorë dënohen me gjobë në masën 5-fish të shumës së tatimit të fshehur.
2. Për rastet e parashikuara në pikat 2, 3 dhe 4 të nenit 11 të këtij ligji, personat fajtorë dënohen me gjobë nga 1000 gjer në 5000 lekë.

Neni 13

Të drejtën e gjobës e kanë inspektorët e tatimeve në komunë, bashki e rrethe dhe punonjësit e Drejtorisë së tatimeve në Minis-trinë e Financave dhe të Ekonomisë.

Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit, përkatësisht te kryetari i zyrës së tatimeve e taksave në komunë e bashki, te kryetari i degës së tatimeve e taksave në rreth dhe te drejtori i Drejtorisë së tatimeve në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, akti i të cilëve është i formës së prerë.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

Shpallur me dekretin nr.263, datë 20.7.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.